

**20050460683**

**L I G J I**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN E LIGJIT PËR GARANCI TË REPUBLIKES**  
**SË MAQEDONISE SIPAS MARREVESHJES PËR HUA QË DO TË LIDHET**  
**NDERMJET BANKES EVROPIANE PËR RINDERTIM DHE ZHVILLIM DHE**  
**ELEKTROEKONOMISE SË MAQEDONISE SH.A. PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT**  
**PËR NDERTIMIN E LARGPERCUESIT 400 KW, PREJ SHTIPI (REPUBLIKA E**  
**MAQEDONISE) DERI NË CERVENA MOGILLE (REPUBLIKA E BULLGARISE)**

Neni 1

Në Ligjin për garanci të Republikës së Maqedonise sipas Marreveshjes për hua që do të lidhet ndermjet Bankes Evropiane për Rindertim dhe Zhvillim dhe Elektroekonomise së Maqedonise Sh.A. për realizimin e Projektit për ndertimin e largpercuesit 400 kv, prej Shtipi (Republika e Maqedonise) deri në Cervena Mogille (Republika e Bullgarise), (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonise” nr.72/2003), titulli i Ligjit ndryshon si vijon:

“Ligji për garanci të Republikës së Maqedonise sipas Marreveshjes për hua të lidhur ndermjet Bankes Evropiane për Rindertim dhe Zhvillim dhe Elektroekonomise së Maqedonise Sh.A. për realizimin e Projektit për ndertimin e largpercuesit 400kv, prej Shtipi (Republika e Maqedonise) deri në Cervena Mogille (Republika e Bullgarise) dhe Amendamentit numer 1 të Marreveshjes për hua që do të lidhet ndermjet Bankes Evropiane për Rindertim dhe Zhvillim dhe Operatorit të sistemit elektropercues të Maqedonise, shoqeri aksionare për percimin e energjise elektrike dhe menaxhim me sistemin elektroenergjetik, në pronesi shtetore (ShA EPMSO)”.

Neni 2

Neni 1 ndryshon si vijon:

“Republika e Maqedonise garanton permbushjen e obligimeve sipas Marreveshjes për hua për realizimin e Projektit për ndertimin e largpercuesit 400 kv, prej Shtipi (Republika e Maqedonise) deri në Cervena Mogille (Republika e Bullgarise) të nenshkuar ndermjet Bankes Evropiane për Rindertim dhe Zhvillim dhe Elektroekonomise së Maqedonise Sh.A. në shume prej 40.470.600 eurosh, si dhe sipas Amendamentit numer 1 të Marreveshjes për hua që do të lidhet ndermjet Bankes Evropiane për Rindertim dhe Zhvillim dhe Operatorit të sistemit elektropercues të Maqedonise, shoqeri aksionare për percimin e energjise elektrike dhe menaxhim me sistemin elektrtoenergjetik, në pronesi shtetore ( ShA EPMSO)”.

Neni 3

Në nenin 3, paragrafin 3, pas fjaleve “sherbime juridike” presja zevendesohet me pike, ndersa teksti deri në fund të paragrafit shlyhet.

Pas paragrafit 3, shtohet paragraf i ri 4 si vijon:

“Obligimin për pagimin e provizionit të pjeses së paterhequr të mjeteve prej 0.5% në vit e ndermerr ShA EPMSO”.

Neni 4

Në nenet 2, 4, 5, dhe 6 fjalet “Elektroekonomia e Maqedonise Sh.A.” zevendesohen me fjalet “Operator i sistemit elektropercues të Maqedonise, shoqeri aksionare për percimin e energjise elektrike dhe menaxhim me sistemin elektroenergjetik, në pronesi shtetore (ShA EPMSO)”.

Neni 5

Ministria e Financave dhe ShA EPMSO do të lidhin marreveshje për rregullimin e të drejtave dhe obligimeve të ndersjella mbi baze të garancise së dhene prane Bankes Evropiane për Rindertim dhe Zhvillim, nga neni 1 të ketij ligji.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi ditën e parë pas ditës së shpalljes në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.